

Shtojca 1

FORMULARI OFERTËS

Emri i Ofertuesit Bashkimi i shoqërive ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION dhe 2T shpk përfaqësuar nga shoqëria ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION

Për: *Bashkia Kamez*

\* \* \*

Procedurakoncesionit/partneritetit publik privat: *E hapur mbi kufirin monetar*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *Për dhënien me koncesion te Shërbimit të Pastrimit, Grumbullimit, Transportimit dhe Seleksionimit të Mbetjeve të bashkisë Kamëz*

Publikimi (nëse zbatohet): *Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]*


Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është 1 350 000 000 lek (një miliard e treqind e pesëdhjetë milion) ; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është 1 620 000 000 lek (një miliard e gjashtëqind e njëzet milion) ; me TVSH

Nr.	Kriteret	Njesia e matjes	Oferta ose referenca ne material
TC 1	Projekti ideja dhe plani I funksionimit dhe menaxhimit te stacionit te trasferimit		Referuar materialit grafik, Projekt info, metodologjise
TC 2	Vleresimi mbi ndikimin ne mjedis dhe ndikimin social		Refruar VNM-se
TC 3	Makinerite dhe pajisjet qe do perdoren		Referuar atyre makineri te paraqitura ne kete procedur
TC 4	Afati ndertimit te stacionit te trasferimit	Muaj	16
FC1	Oferta ekonomike per 12 vjet pa TVSH	Lek	1 350 000 000
FC2	Tarife Koncesionare	%	1.5

## Aneks 2

## Volumet e punimeve te cilat do te kryeje Koncesio



	EMERTIMI I SHERBIMEVE	NJESIA	VOLUMET PUNIMEVE	VOLUME NE DITE	ÇMIMI NJESI	VLERA (Dite)	DITE PUNE MIT
1	GRUMBULLIMI DHE TRANSPORTIMI I MBËTURINAVE URBANE DHE TREGJEVE (kontenier 1.7 m3)	Zbrazje/dite	532	532	196.6	104,591	365
2	LARJA DHE DEZIFEKTIMI I KONTENIEREVE	cope / 30 dite	532	18	789.08	14,203	365
3	MIREMBAJTJA E VEND GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE GJATE DITES DHE GRUMBULLIMI I MBETJEVE NDERTIMORE DHE TE VELLIMSHME(1 here ne 2 dite)		287	144	200.03	28,804	365
4	FSHIRJA E RRUGEVE DHE TROTUAREVE ME KRAHE	m2/dite	104,600	104,600	0.206	21,548	365
5	FSHIRJA E RRUGEVE ME MAKINERI(1 here ne 7 dite)	ml/ditë	22,658	3,237	1.577	5,105	305



LARJA E RRUGEVE NJE HERE NE DITE(1here ne 2 6 dite)	m2/dite	115,594	115,594	0.154	17,801
---	---------	---------	---------	-------	--------



## SPECIFIKIMET TEKNIKE

**1 Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve Urbane dhe Tregjeve.****1.1 Volumet e punimeve**

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve për vendosjen e 532 kontenierëve të ndara në 287 PGM (pika të grumbullimit të mbetjeve) me volum 1.6 m<sup>3</sup>, brenda zonës së kontraktuar.

**1.2 Specifikime teknike dhe metodologjia**

Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

- a. Zbrazjen e kontenierëve me makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar, mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 10 m nga çdo kontenier, pastrimin dhe fshirjen me fshesë me dorë të sipërfaqes prej 30 m<sup>2</sup> rreth çdo pike grumbullimi, si dhe rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur. Më pas makinat teknologjike kryejnë transportin e mbeturinave në fushën e depozitimit të tyre.
- b. Duhet të bëhet dezinfektimi ditor, pas zbrazjes së çdo kontenieri, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, brenda çdo kontenieri ose duke përdorur sistemin e dezinfektimit që duhet ta ketë çdo makinë teknologjike, duke përdorur të tretur lëndën e pluhurit të gëlqeres me 5% përmbajtje klori.

**1.3 Plani i vendosjes së kontenierëve dhe grafikët e punimeve**

- a. Autoriteti kontratues ka përcaktuar në fillim të kësaj kontrate pikat ekzakte të grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane, dhe numrit të kontenierëve për secilën pikë, në të gjithë zonën e kontraktuar ku përfshihen
- b. Koncesionari është i detyruar të zbatojë planin fillestar të pikave dhe kontenierëve të kërkuar (bashkëngjitur specifikimeve teknike) si dhe çdo ndryshim të tyre përgjatë kohës së zbatimit të kësaj kontrate. Ky plan mund të ndryshojë gjatë kohës së zbatimit të kontratës me propozim të operatorit të shërbimit ose nga Autoriteti kontraktorsipas nevojave për përmirësimin e shërbimit dhe mirë organizimit të tij, ose si rezultat i ndryshimeve që mund të ndodhin në infrastrukturë gjithmonë pas kërkesës së njëres palë dhe bëhen të zbatueshme pas miratimit të Autoritetit kontraktor.
- c. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga Koncesionari dhe miratohen nga Autoritetit kontraktor përpara fillimit të shërbimit të pastrimit. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë konsiderohet e nevojshme. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:
  1. Oraret e operimit në secilën pikë kontenierësh.
  2. Llojin, targa dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.



3. Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse.
4. Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.
- d. Grafikët për largimin e mbeturinave që do të paraqiten për miratim përpara fillimit të kryerjes së shërbimit nga koncesionari, duhet të paraqiten në mënyrë të tillë që të gjitha punimet të kryhen brenda orëve të natës (për zonën urbane dhe gjysëm urbane) duke filluar jo më parë se ora 19.00, me qëllim që në orën 7.00 zona urbane dhe gjysëm urbane të jetë krejtësisht e pastër, ndërsa për zonën rurale ky shërbim të kryhet gjatë ditës.
- Ndryshimet në orarin e operimit dhe përfundimit të shërbimit në zonë, do të pranohen vetëm për shkak të pamundësisë objektive të kryerjes së shërbimit të parashikuar si dhe në rastet e ndryshimit të orarit për rrugët tregtare, por gjithmonë pasi të jenë verifikuar dhe miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor, ndryshimet në Grafikon e Punimeve.
- e. Autoritetit kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjoba për mospërbushjen e tyre.
- f. Në rast se për arsye objektive nuk arrihet vendosja e planifikuar e numrit të kontenerëve dhe e pikave të grumbullimeve të mbetjeve, shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve do të shpeshtohet në funksion të sasise së depozituar të mbetjeve por gjithmonë duke mos kaluar parashikimin kontraktual.

### 1.3.1 Rregulla për tu zbatuar

- a. Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të patransportuara dhe mbeturina të lëna në zonën përreth kontenerëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, Koncesionari duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit dhe do të vendosen penalitete.
- b. Koncesionari ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen në ambjente publike brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur Koncesionari ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së kontenerëve dhe përfshirjen në grafikun e punimeve.
- c. Koncesionari duhet të informojë me shkrim Autoritetin kontraktor në mënyrë periodike për të gjitha nënkontratat e pastrimit që do ketë me të tretë, të reklamojë numrin e mjeteve dhe punëtorë shtesë për këto shërbime për të garantuar cilësinë e kërkuar të shërbimeve në kontratën me Autoritetin kontraktor.
- d. Koncesionari detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, pajisjeve.
- e. Koncesionari detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertë për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.



- h. Në asnjë rast nuk duhet të kryhet largimi i mbeturinave urbane nga kontenierët në akset kryesore, para se të jetë kryer fshirja dhe pastrimi i rrugëve ku ndodhen. Në të kundërt Koncesionari duhet kryejë përsëri zbrazjen e kontenierëve pa shpenzime ose duhet të përdorë mjete shtesë për të garantuar që kontenierët të jenë bosh pas përfundimit të të gjitha shërbimive të pastrimit.
- g. Në qoftë se gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballë me penaltetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjopa të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.
- i. Përdorimi i uniformave për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mosbatimi aplikohen gjopa për mosplotësim këtij detyrimi.

#### 1.4 Mjetet dhe pajisjet

Koncesionari duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, (mbledhjes, transportit, largimit të mbeturinave) dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

- a) makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-12 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 1 (një) copë;
- b) makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 7-9 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 2 (dy) copë;
- c) makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 2-5 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 2 (dy) copë;
- d) makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 6 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 1 (një) copë;
- e) makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 1 (një) copë;
- f) makinë vetëshkarkuese e hapur nga sipër, me hapje të spondit anësor ose ng pajisur me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve të vël dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj.; viti i prodhimit jo më poshtë se 2010. jo më pak se 3 (tre) copë;



g) makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m<sup>3</sup>, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 2 (dy) copë;

h) makinë për larjen e rrugëve, (autobot) i pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se 1 (një) copë.

Të gjitha makineritë teknologjike që do përdoren për zbatimin e kësaj kontrate duhet të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve të përcaktuara në kapitullin "Specifikimet teknike", pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit.

## 2. Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:

- a. Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren nga Koncesionari për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
- b. Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuar nga Autoriteti kontraktor. Ato duhet të mbahen në gjëndje të pastër dhe të rregullt si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të jenë gjendje për të siguruar plotësimin e gatishmërisë së mjeteve.
- c. Mjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dezinfektohen çdo ditë pas përfundimit të punës.
- d. Të gjithë kontenierët e përdorur për zbatimin e kontratës duhet të mbahen të pastër, në gjëndje të mirë teknike. Në rast dëmtimesh, djegiesh, deformimesh të kontenierëve, si dhe dëmtime rrotash dhe kapakësh, të cilat çojnë në mosfunksionimin e plote teknik, higienik ose estetik të tij gjatë kohëzgjatjes së kontratës si dhe mungesës së kontenierëve, Koncesionarika përgjegjësinë për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontenierëve për çdo rast dhe për çdo shkak. Koncesionari do të riparojë ose të zëvendësojë kontenierët brenda 15 ditëve nga momenti i konstatimit të dëmtimit dhe/ose njoftimit nga Autoriteti kontraktor për dëmtimin e kontenierëve. Në rast të mosriparimit të plotë të kontenierëve ndaj operatorit të shërbimit aplikohen penalitete.
- e. Koncesionari duhet të vëjë në përdorim emrin e tij për korespondencën e përbashkët, lidhjen telefonike, shenjat dhe targat e makinave dhe kontenierëve.
- f. Detyrimisht në të gjithë makinat dhe kontenierët duhet të shkruhenmesazhe për edukimin mjedisor, numri i telefoni i gjelbër i Autoritetit Kontraktorsipas një formati të miratuar paraprakisht po nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu në të gjitha mjetet dhe kontenierët e shpërndarë përveç mbishkrimeve të mësipërme, duhet të prezantohen shpjegues të qartë për llojin e mbeturinave që mblidhen, si dhe orarin kur largohen mbeturinat.

### 3. Larja dhe dezinfektimi i kontenierëve

#### 3.1 Volumet e punimeve

Koncesionari do të lajë dhe dezinfektojë 532 kontenierë të volumeve 1.6 m<sup>3</sup>/ në muaj ose mesatarisht 18 kontenierë/ditë, sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor.

#### 3.2 Metodologjia

1. Koncesionari do të grumbullojë dhe transportojë kontenierët çdo natë në autoparkun e tij dhe të kryejë larjen e plotë dhe dezinfektimin e tyre atje. Kontenierët do të largohen detyrimisht pas zbrazjes së plotë të tyre.
2. Për të mundësuar kryerjen e këtij shërbimi Koncesionari do të ketë në dispozicion një numër të nevojshëm kontenierësh rezervë për të zëvendësuar çdo natë kontenierët e larguar për tu larë.
3. Kontenierët për mbledhjen e mbeturinave urbane detyrimisht lahen nga brenda dhe nga jashtë me ujë me presion, duke përdorur furçe dhe solucione larëse.
4. Me shërbim dezinfektimi kuptojmë realizimin shërbimit të dezinfektimit dhe deratizimit të të gjithë sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme të kontenierit.

#### 3.3 Grafikët e punimeve

1. Grafikët e punimeve për transportin, larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve, përgatiten nga Koncesionari dhe miratohen nga Autoriteti kontraktor në rast se do të ketë ndryshime.
2. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga Koncesionari.
3. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar dhe për të vendosur penalitete, gjoha dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

#### 3.4 Rregulla për t'u zbatuar

Ky shërbim do të kryhet detyrimisht pasi të jetë bërë zbrazja dhe pastrimi i kontenierëve të mbledhjes së mbeturinave urbane, tregjeve, etj..

### 5. Mjetet dhe pajisjet

- a) Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 1 (një) copë.
- b) Lëndë dezinfektuese dhe aromatizuese për dezinfektimin e kontenierëve.
- c) Koncesionari duhet të ketë të instaluar në autoparkun e tij depozitë uji dhe një tjetër për lëndën dezinfektuese si dhe mjete pune (pompë dhe pistoleta uji) për larjen me presion dhe dezinfektimin e kontenierëve.



- d) Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gatë për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.

## **6. Mirëmbajtja e vendgrumbullimeve të mbetjeve gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme.**

### **6. 1 Volumet e punimeve**

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht pikat e grumbullimit të mbetjeve, 287 vendgrumbullime mbetjesh. Shërbimi i mirëmbajtjes gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme, do të kryhet në të gjitha pikat e grumbullimit si dhe në gjithë hapësirat publike e territoriale të zonës së kontratuar.

### **6.2 Metodologjia e punës dhe rregulla për zbatim.**

Shërbimi i mirëmbajtjes së pikave gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme, konsiston në:

- a. Mirëmbajtjen dhe pastrimin gjatë ditës të mbetjeve urbane të hedhura dhe depozituara jashtë kontenerëve, mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme të depozituara në zonënperkatëse, si dhe të mbetjeve urbane voluminoze (amballazhe) që tejm bushin artificialisht kontenerët dhe pengojnë mbetjet e tjera urbane për t'u depozituar nëpër kontenerë, në mënyrë që të gjitha pikat dhe kontenerët të jenë të pastër në vazhdimësi gjatë gjithë ditës. Nuk ka kufizime në pastrimin e sipërfaqes rreth kontenerit dhe Koncesionari është i detyruar të largojë çdo mbetje urbane në të gjithë zonën perkatesesado larg kontenerit të jetë hedhur.
- b. Për grumbullimin dhe ngarkimin e mbeturinave inerte dhe të vëllimshme, të hedhura jashtë kontenerëve, si dhe në gjithë hapësirat publike dhe territoriale të zonës do të përdoren kamionçina vetshkarkuese me mbulesa të posaçme për mos lejuar derdhjen e mbetjeve. Sipas nevojave që mund të ketë çdo pikë mund të jetë e nevojshme pastrimi disa herë në ditë të pikave dhe kontenerëve mbi të cilët në vazhdimësi ndotet gjatë orëve të ndryshme të ditës.
- d. Pas pastrimit kontenerët kthehen në vendqëndrimin e tyre të mëparshëm.
- f. Grafikët e punimeve për realizimin e këtij shërbimi, përgatiten nga koncesionari dhe miratohen nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë lind e nevojshme. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:
  1. Oraret e operimit në secilën vendgrumbullim mbetjesh.
  2. Llojin, targën dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.
  3. Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse.
  4. Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.
- g. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga Koncesionari.
- h. Grafikët që do të paraqiten për miratim, duhet të përgatiten në mënyrë të tillë që punimet të fillojnë nga ora 10.00 deri në 18.00 , me qëllim që gjithë kësaj periudhe kohore të gjithë kontenerët dhe vendet rreth tyre të jenë krejtësisht të pastër.

- i. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar dhe për të vendosur ndalës, penalitete dhe gjopa për mospërbushjen e tyre.

### 6.3 Mjetet dhe pajisjet

Koncesionari duhet të vërë në dispozicion për kryerjen e këtij shërbimi, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane dhe mbetjeve ndërtimore, të vëllimshme si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

- a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-12 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 1 (një) copë;
  - b) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 7-9 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 2 (dy) copë;
  - c) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 2-5 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 2 (dy) copë;
  - d) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 6 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 1 (një) copë;
  - e) Makinë vetëshkarkuese e hapur nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisur me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve të vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj;. Viti i prodhimit jo më poshtë se 2010. Jo më pak se 3 (tre) copë;
- Vegla pune si lopata, fshesa për të gjithë shoferët dhe punëtorët.
  - Çdo makineri për kryerjen e këtij shërbimi duhet të pastrohet dhe lahet, në fillim ose në fund të itinerarit ditor.
  - Një listë e makinave për transportin e mbeturinave inerte dhe skeletike do t'i paraqitet Autoritetit kontraktor para fillimit të veprimtarisë së mësipërme.
  - Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit dhe një numër kontenierësh me volum të madh duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.
  - Detyrimisht në të gjithë makinat duhet të shkruhet mesazhe për edukimin ambjentat, numri i telefonit i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht.



## 7. Fshirja e rrugëve dhe trotuareve me krahë.

### 7.1 Volumet e Punimeve

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët, trotuaret dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar.

Koncesionari do të fshijë me krahë dhe do të kryejë të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse parashikuar në metodologji për të gjitha rrugët dhe trotuaret e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej **104,600** m<sup>2</sup> në ditë. Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes sipas hartës bashkëngjitur.

### 7.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe trotuareve me krahë konsiston në:

- a. Fshirjen me punëtorë mefshesë të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore, të kategorive I, II, duke mbuluar sipërfaqen e plotë të trotuarit dhe njësipërfaqe rruge 2 m nga kuneta.
- b. Në vendet ku është e pamundur të kalojë fshesa anësore e makinës teknologjike, (si psh. poshtë makinave apo kur ka pengesa të tjera) Koncesionari duhet të pastrojë me punëtorë.
- c. Fshirjen dhe pastrimin me punëtorë pastrimi të gjitha segmenteve të zëna nga parkimi, trotuareve, dhe rrugëve dytësore në të cilat është e pamundur kryerja e pastrimit me mjete teknologjike.
- d. Pas fshirjes me makineri teknologjike, punëtorët e pastrimit (fshirjes) pastrojnë çdo lloj mbeturine që ka mbetur nga procesi teknologjik i fshirjes, në mënyrë që rrugët të jenë plotësisht të pastra. Edhe ky shërbim manual pastrimi përfshihet në procesin e fshirjes si dhe në çmimin për njësi të saj.
- e. Koncesionari duhet të zbrazë, pastrojë vendin përreth dhe të mbajë pastër çdo ditë të gjithë koshat rrugorë brenda zonës së kontraktuar. Për këtë operojnë punëtorë dhe makina të veçanta. Shërbimi i zbrazjes dhe pastrimit të ambjentit rreth tyre bëhet gjatë natës.
- f. Procesit të fshirjes dhe pastrimit i nënshtrohen të gjitha rrugët dhe trotuaret e parashikuara në zonën e kontraktuar (të asfaltuara, me kalldrëm si dhe trotuaret e qytetit).

### 7.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve

- a. Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora 21.00-04.00.
- b. Për pastrimin e rrugëve të pandriçuara Autoriteti kontraktor mund të ndryshojë dhe miratojë grafikun dhe oraret e shërbimit, pas kërkesës të njëres palë, për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.  
Këtu mund të përfshihen edhe rrugët brenda blloqeve të banimit apo rrugët dytësore që kanë lehtësi pastrimi ditë ditës nga munësia e parkimit.

- c. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga koncesionari dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.
- d. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:
1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.
  2. Numri i punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.
- e. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga Koncesionari.
- f. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

#### 7.4 Rregulla për t'u zbatuar

- a. Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, Koncesionari duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 2 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit.
- b. Koncesionari duhet të ketë në efikasitet një "Zyrë të Kontaktimit" për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të Koncesionari duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktor dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 2 orësh nga marrja e njoftimit.
- c. Koncesionari detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.
- d. Për raste të veçanta Koncesionari është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.
- e. Gjatë procesit të fshirjes i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusëve të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse, zonat e gjelbra, në banesat ujore natyrale apo artificiale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie Koncesionari detyrohet t'i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes apo mospastrimit të tyre brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballët me penalitete sipas kësaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.



- f. Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes për shkak të ndotjes që shkaktëjnë.
- g. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjopa për mosplotësim të tyre.
- h. Gjithashtu punëtorët e pastrimit duhet të përfitojnë trajtim special në përputhje me normat higjienike në fuqi për shkak të llojit të punës që kryejnë.

## 7.5 Mjetet dhe pajisjet

Koncesionari duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me krahëtë rrugëve dhe trotuareve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

- a. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.
- b. Pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë. Punëtorët e fshirjes duhet të jenë të pajisur: me fshesa, kruajtëse, lopata, kazane dore lëvizëse dhe karroca dore.

## 8. Fshirja e rrugëve me makineri teknologjike.

### 8.1 Volumet e Punimeve

Autoriteti kontrator ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët dhe gjatësitë lineare për të gjithë zonën e kontraktuar.  
Koncesionari do të fshijë me makineri teknologjike fshesëpër të gjitha rrugët dhe sheshet e përcaktuara në zonën që do të kontraktohet në një gjatësi lineare prej 3237m në ditë.

### 8.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i fshirjes së rrugëve me makineri konsiston në:

- a. Fshirjen me makina teknologjike fshesë të të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve, duke mbuluar gjithë gjatësinë lineare të lirë nga parkimi. Më pas çdo mbeturinë e mbetur nga pastrimi me mjete teknologjike, pastrohet nga punëtorët e shërbimit të fshirjes me krahë..
- b. Në të gjitha gjatësitë lineare dhe segmentet e lira nga parkimi, të rrugëve , të përcaktuara në volumet e shërbimit të fshirjes me makineri. Fshirja detyrimisht duhet kryer me makinë teknologjike. Në rast të kundërt do të konsiderohet i pavlefshëm shërbimi i kryer.

### 8.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve

- a. Fshiria e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora 21.00-04.00.

- b. Fshirja me makineri teknologjike do të kryhet sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor, me qëllim që në orën 7.00 zona të jetë krejtësisht e pastër.
- c. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zones, përgatiten nga Koncesionari dhe miratohen nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.
- d. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohet saktë:
1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.
  2. Llojin dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.
- e. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga Koncesionari. Koncesionari nuk mund të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
- f. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, përdorimin e makinave teknologjike, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

#### 8.4 Rregulla për tu zbatuar

- a. Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, Koncesionari duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e Koncesionari.
- b. Do të konsiderohet e pavlefshme fshirja e rrugës me makineri teknologjike për fshirjen e rrugëve, kur kjo e fundit gjatë procesit të punës operon me shpejtësi më të madhe se 6 km /orë.
- c. Koncesionari detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, shoferëve dhe pajisjeve për fshirjen e rrugëve.
- d. Për raste të veçanta Koncesionari është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.
- e. Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes së rrugëve, për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

#### 8.5 Mjetet dhe pajisjet

Koncesionari duhet  
me makineri të rrugës  
mjete dhe pajisje:



- a. Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m<sup>3</sup>, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrual, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 2 (dy) copë;
- b. Makineritë teknologjike që do përdoren për shërbimin e fshirjes duhet të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve sipas ofertës dhe në përputhje me këtë kontratë si dhe të jetë konform normave teknike të Komunitetit Europian.

#### **Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:**

- a. Të gjitha automjetet të cilat duhet të përdoren nga Koncesionari për fshirjen e rrugëve, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontrator për gjëndjen e gatishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
- b. Çdo makineri për fshirjen e rrugëve duhet të lahen dhe pastrohen në fillim ose në fund të itinerarit ditor dhe duhet të jetë e pajisur me një sistem pompimi uji i cili shërben për mbrojtjen nga pluhuri.
- c. Detyrimisht në të gjithë makinat dhe kontenierët duhet të shkruhet mesazhe për edukimin ambjental, numri i telefonit i gjelbër i Autoritetit kontrator sipas një formati të miratuar paraprakisht.
- d. Automjetet, pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kësaj kontrate.
- e. Një listë e makinave fshirëse do t'i paraqitet Autoritetit kontrator para fillimit të veprimtarisë së fshirjes.

### **9. Larja e rrugëve me makinë teknologjike**

#### **9.1 Volumet e Punimeve**

Autoriteti kontrator ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët dhe sipërfaqet e tyre që do të lahen me presion për të gjithë zonën e kontraktuar si për shërbimin e parë të larjes gjatë natës ashtu dhe për shërbimin e dytë të larjes gjatë ditës.

1. Koncesionari do të bëjë larjen me presion të rrugëve me makinë teknologjike, si shërbim një herë në ditë gjatë natës, parashikuar në metodologji për të gjitha rrugët dhe sheshet e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej 115567 m<sup>2</sup> në ditë përgjatë 305 ditëve të periudhës kontraktuale. Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e larjes me makineri.

#### **9.2 Specifikimet teknike dhe metodologjia**

Shërbimi i larjes me presion, me makineri teknologjike konsiston në:

1. Larjen me presion me makineri teknologjike larëse, si shërbim një herë në ditë, të gjithë rrugëve kryesore dhe anësore të parashikuara, në mënyrë që makinat larëse të mbu parashikuar.

2. Larjen me presion, me makineri teknologjike larëse, si shërbim i dytë ditor, të të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore të parashikuara për këtë shërbim, në mënyrë që makinat larëse të mbulojnë me shërbim të gjitha sipërfaqet e plota të tyre brenda kohës së parashikuar.
3. Gjatë shërbimit të parë të larjes (gjatë natës) shpejtësia e operimit të makinave larëse gjatë procesit të larjes (zbrazjes së ujit) duhet të variojë nga 8-10 km/orë kurse gjatë shërbimit të dytë të larjes nga 15-20 km/orë.

### 9.3 Plani i Punës dhe grafikët e punimeve

1. Larja e rrugëve, si shërbim një herë në ditë, do të bëhet çdo ditë, gjithmonë mbas shërbimit të pastrimit (fshirjes) të rrugëve, nga ora 24.00-07.00.
2. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimeve të larjes së rrugëve, përgatiten nga Koncesionari dhe miratohen nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.
3. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë: 1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar. 2. Llojin dhe itinerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin. 3. Numrin e punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.
4. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga Koncesionari. Koncesionari nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
5. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur penaltete, gjoba dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

### 9.4 Rregulla për tu zbatuar

1. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kontrollojë gjatë kryerjes së shërbimit dhe pas përfundimit të tij, respektimin e standarteve në presionin e ujit për larje si dhe duke kontrolluar herë pas here sasinë e ujit të përdorur për larjen e sipërfaqes së parashikuar. Në rastet kur evidentohet presion i pamjaftueshëm në larje apo sasi e vogël e ujit të përdorur, shërbimi i larjes do të konsiderohet i pavlefshëm.
2. Koncesionari duhet të kryejë shërbimin e larjes me presion të rrugëve duke respektuar standartin e harxhimit të 0.6 litër ujë për m<sup>2</sup> për larjen e ditës.
3. Larja duhet të  
100ml ujë.



4. Në të gjitha rastet kur nuk është e nevojshme kryerja e shërbimit të larjes me makineri për shkak të kushteve atmosferike si shi apo ngjirje, Koncesionari nuk do të kryejë këtë shërbim dhe si rrjedhim nuk do të paguhet.
5. Përfaqësuesit e Autoritetit kontraktor, do të shënojnë në procesverbalet ditore dhe situacionet mujore, të gjitha ditët dhe volumet përkatëse, që për shkak të reshjeve nuk është kryer shërbimi i larjes së dytë dhe mund të kërkojë Operatorit të Shërbimit kryerjen e këtij shërbimi në ditët e tjera të vitit ose gjatë stinës së verës kur të jetë e nevojshme, në përputhje me çmimet njësi të preventivit të punimeve dhe sipërfaqeve të rrugëve sipas listës së rrugëve bashkëngjitur kontratës, një kërkesë zyrtare të Autoritetit kontraktor, si dhe pagesa do të bëhet atëherë kur të kryhet.
6. Do të konsiderohet e pavlefshme larja e rrugëve në kushtet e reshjeve atmosferike të përshkruara më sipër. Do të bëjë përjashtim vetëm në rastet kur kryerja e këtij shërbimi kërkohet nga Autoriteti kontraktor për shkaqe të ndryshme.
7. Autoriteti kontraktor do të nxisë Koncesionarin të përdorë burime të tjera për sigurimin e ujit për larjen e rrugëve, si puse, etj.
8. Listat përkatëse të rrugëve që do lahen i bashkëngjiten kësaj kontrate.
9. Të gjitha shpenzimet për ujin, që do të përdoret për larje, do mbarten nga Koncesionari.
10. Koncesionari detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive dhe pajisjeve për larjen e rrugëve.

#### 9.5 Mjetet dhe pajisjet për larjen e rrugëve

Koncesionari duhet të sigurojë për realizimin e larjes me presion të rrugëve sipas përcaktimeve të kontratës, të gjitha punimet, materialet, pajisjet si dhe lejet përkatëse.

Koncesionari duhet të vërë në dispozicion dhe të përdorë për plotësimin e detyrave kontraktuale të larjes së rrugëve këto mjete:

- a) Makinë për larjen e rrugëve, (autobot) i pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtjes jo më pak se 10,000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se 1 (një) copë.

Detyrimisht në të gjithë makinat duhet të shkruhet mesazhe për edukimin ambjental, numri i telefonit i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht.

#### 9.6 “Edukimi Publik Mjedisor”

Në termin “Edukim Publik”, do të nënkuptohet aktiviteti publicitar i Koncesionarit për të rritur dhe përmirësuar njohuritë e konsumatorit përsa i përket mbledhjes, përpunimit dhe largimit të mbetjeve, ndarjes së mbetjeve në burim, etj periudhës së kontratës.

Koncesionari duhet të krijojë një kontakt të vazhdueshëm me komunitetin e zonës i cili luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në mbarëvajtjen e punës së Koncesionarit por edhe në minimizimin e ndotjes së ambjentit. Ky kontakt mund të realizohet si nëpërmjet mass-mediaeve ashtu edhe nëpërmjet shpërndarjes së materialeve informuese.

Koncesionari duhet të mundësoj shpërndarjen e materialeve informative të paktën një herë në gjatë muaj (duke filluar nga dita e firmosjes së kontratës). Materialet informative duhet të jenë në formën, fletëpalosjeve si dhe broshurave duke përfshirë në to informacione mbi shkaqet dhe shkaktarët e kësaj ndotjes, parandalimin e saj si dhe masat që mund të merren për minimizimin e ndotjes. Materialet sensibilizuese duhet të jenë të tilla që të ftojnë qytetarët e kryeqytetit të bëhen pjesë aktive e një shoqërie të emancipuar dhe me një edukatë mjedisore.

#### **Te dhena teknike te kontenerit 1600 litra:**

Kontenerët do të përdoren për grumbullimin e mbetjeve urbane dhe duhet të kenë karakteristikat si më poshtë vijojnë:

##### ***Trupi i kontenerit (vaska):***

Trupi i kontenerit nga brenda (vaska e zinguar). Ekstra përforcim i bazës së rrotës, i ngjitur tek konteneri. Sistem kullimi fundor për derdhjen e lëngjeve të grumbulluar nga mbetjet apo gjatë larjes së kontenerit. Kapaciteti i plote 1700 litra. Doreza anesore për terheqjen e kontenerit.

Kontenerët duhet të jenë të lycr me bojë (vaska) Portokalli, (kapaku blu). Spesori i profilit të vaskës 1.5-4 mm.

##### **Kapaku**

Metalik. Me përforcues të tërthortë për ekstra rezistencë. Profil i harkuar ose i drejtë për rrjedhje të ujrave të shiut. Sistemi i hapjes së kapakut me pedale qendrore. Ndër të tjera kapaku duhet jetë i pajisur edhe me një dorezë, në pjesën e përparme ose anesore, për raste të hapjes së kapakut në mënyrë manuale. Ngjyra e kapakut, blu.

##### **Pedalja**

Pedalja duhet të jetë me profil metalik me spesor 4 mm për ekstra rezistencë.

##### **Rrotat**

Rrota rezistente me çelik të galvanizuar në qendër dhe unazë gome rezistente në pjesën e kontaktit me tokën. Diametri i rrotës 200 mm dhe me rrotullim 360°. 4 rrota të kthyeshme (me kokë rrotulluese), me gomë plastike solide, me kuzhineta, kapaciteti mbajtës për rrotë të jetë 250kg;

##### **Modeli i kapjes së kazanit**

Attacco Bologna/ Din.

##### **Sinjalistika**

Operatori duhet të sigurojë dhe ngjisë adezivë tek kazanët, me informacion mbi mënyrën e dorëzimit të mbetjeve, ndalimet, etiketa, adezivë për ndalim parkimi para kazanëve, shirita me ngjyre fosforeshente. Operatori mund të ofrojë edhe modele të tjera por duke marrë



paraprkisht miratimin e autoritetit kontraktor si dhe duke respektuar gjithnje kohen e parashikuar për dorëzimin e kontenierëve.

#### Përputhja

Sipas normativës UNI EN 840 (UNI 10571).

#### Të tjera.

Kazani duhet të jetë në gjendje të durojë gjatë kohës, për të gjithë përbërsit, temperatura nga -20°C deri +50°C;

Kazani duhet të strukturuar në mënyrë që të garantojë një mbajtje peshe deri në 450 kg, pa pësuar asnjë deformim permanent

Hapja minimale, me gjysëm pedale duhet të jetë 450mm, ndërsa në fazën e zbrazjes ose të larjes duhet të jetë minimalisht 1000mm.

#### Të dhena teknike mbi diferencimin e mbetjeve.

- ST e automatizuara përdorin kombinimin e ekraneve, ndarësit magnetikë, klasifikuesit e ajrit dhe sistemet e transportuesve me më shumë se një linjë përpunimi. Zgjedhja e pajisjeve do të varet nga kapaciteti i synuar dhe nga natyra dhe përbërja e mbetjeve hyrëse.
- Operacionet e ST fillojnë me regjistrimin, inspektimin dhe vendosjen e mbetjeve të përziera ose të veçuara në zonën e pranimit. Mbetjet e pazakonta largohen direkt pa hyre në procesin e rikuperimit të tyre; ato shkojnë direkt në destinacionin final ose u jepen paleve të interesuara, ndërsa pjesa tjetër e mbetjeve është vendoset në një transportues për ndarjen e tyre sipas modelit të ST të përzgjedhur
- Për mbetjet e përziera, materialet e biodegradueshme ndahen dhe grumbullohen në një ambient tjetër të ndertuar sipas parametrave për këtë qëllim ose ngarkohen në kamionë për t'u dërguar në lëndfill brenda 24 oreve.
- Mbetjet e riciklueshme ose të rikuperueshme peshohen dhe ruhen përkohësisht në konteinerët e caktuar. Kur grumbullohet sasi të mjaftueshme, këto mbetje presohen dhe dergohen në vendin e caktuar.
- Regjistrimet e sasisë së mbetjeve hyrëse dhe dalëse duhet të mbahen për qëllime monitorimi dhe për vlerësimin e bilancit masiv të objektit.
- Stacioni i transferimit duhet të pajiset me mates të peshes për të peshuar sasitë e mbetjeve hyrëse dhe dalëse.
- ST-të tipike veprojnë 8 orë në ditë të hënave deri të shtunave.
- Kapaciteti përpunues duhet të jete minimalisht 100 ton/ditë.
- Një stacion transferimi duhet të kete minimalisht mjetet dhe pajisjet si më poshte (liste jo shteruese):

Lloji i pajisjes	Qellimi i perdorimit
Peshore	Peshimin e mbetjeve ne hyrje dhe mbetjeve te riciklueshme
Ure-mbajtese	mbajtjen e sasive te medha te mbetjeve

Tavoline ndarese te mbetjeve	Ndarje manuale te mbetjeve dhe perpunim i tyre
Fadrom	ngarkimin mbetjeve ne sistemin qarkullues te tyre apo nga tavolinat. ngarkimin e mbetjeve te riciklueshme ne kamionet e transportit etj
Linje transportuese	Prites i mbetjeve dhe qarkullimi i tyre per perpunim
Sistem transportues	Levizje e mekanizuar e mbetjeve per perpunim
Trommel	Perpunim i mbetjeve mixe I bazuar ne madhesine e tyre
Ndares magnetik	ndarja e materialive me baze metali
Ajer-klasifikues	Ndraja e mbetjeve si letra, qeset plastike bazuar ne madhesi, forme dhe denstitet.
Paketues materialesh	Paketues i shisheve plastike per ti bere te manovrueshme per transport.
Presja	sherben per te ngjeshur materialet e riciklueshme
vinc pirun	Sherben per te ngritur materialet e riciklueshme



Tiranë, më 30.05.2018

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ ECO CLEANING” SH.P.K.**

**KAPITULLI I**  
**EMËRTIMI, FORMA, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, SELIA, KOHËZGJATJA**

**NENI 1**  
**EMËRTIMI DHE FORMA E SHOQËRISË**

- 1.1** Shoqëria “ECO CLEANING” SHPK, është e organizuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe përbëhet nga ortakët e mëposhtëm:
- Shoqëria “ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” shpk, , me numwr biznesi 70086447 , me seli ne adresen: Rr. “Ndue Pwrlleshi”, Kompleksi USLUGA PRishtinw Kosovw, perfaqesuar nga administrator i saj, Imer Ademi i lindur me 18 Shkurt 1957 në Prishtinë, mbajtës i letërnjoftimit me nr personal 1011458145, të lëshuar nga MPB. ER. Së Kosovës me dt.25.02.2009 dhe me afat skadimi 25.02.2019
  - Shoqëria 2T shpk , person juridik regjistruar me NUIS K017310M me adresë në Tiranë perfaqesuar nga Administratori Artan Sako , madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal H20530054L.
- 1.2** Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “ECO CLEANING” SHPK.

**NENI 2**  
**BAZA LIGJORE**

- 2.1** Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar, si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë pozitën juridike të veprimtarisë private dhe ligjit 125/2013 Për koncesionet dhe partneritetin publik privat, i ndryshuar.
- 2.2** Kjo shoqëri fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

### **NENI 3 OBJEKTI**

3.1 Objekti i aktivitetit të kësaj shoqërie është:

Shërbim i pastrimit, grumbulimit, transportit dhe seleksionimit të mbetjeve urbane nëpërmjet ndërtimit të impianit të diferencimit për Qytetin e Kamzës dhe transferimi te Autoritetit Kontraktor.

### **NENI 4 SELIA**

4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Rreshit Petrela, Kompleksi USLUGA, pallati nr.53, njësia administrative nr. 9 Tiranë.

### **NENI 5 KOHEZGJATJA**

5.1 Shoqëria ka një kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) vjetësh. Ajo mund të përfundojë veprimtarinë përpara këtij afati në rastet e prishjes, falimentimit ose të likuidimit të shoqërisë, të parashikuara këto në legjislacionin tregtar shqiptar në fuqi.

## **KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT**

### **NENI 6 KAPITALI THEMELTAR**

6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 10,000 (dhjetemijë) Lekë i ndarë në një 2(dy) kuota. Çdo kuotë njësi jep të drejtën e një vote. Kapitali themeltar i shoqërisë nënshkruhet tërësisht nga Ortakët.

6.2 Pjesët e kapitalit të shoqërisë zotërohen nga Ortakët, si më poshtë vijon:

- Ortaku "ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" SHPK, zotëron 1 (një) kuotë, të barabartë me 95% (nëntëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit themeltar.
- Ortaku "2T" SHPK, zotëron 1 (një) kuotë, të barabartë me 5% (njëqindpërqind) të kapitalit themeltar.

### **NENI 7 TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR**

7.1 Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen vetëm me akt noterial, nëpërmjet:

- a) shitblerjes;



- c) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

- 7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 7.3 Pjesët e kapitalit mund t'u transferohen edhe të tretëve, por pasi të jetë ushtruar dhe refuzuar e drejta e parablerjes nga ortakët e shoqërisë dhe këta të kenë hequr dorë shprehimisht nga kjo e drejtë. Në rastin e transferimit të pjesëve të kapitalit tek të tretët duhet marrë paraprakisht miratimi nga Autoriteti Kontraktues, siç parashikohet në Kontratën e Koncesionit të përmendur në nenin 2 të këtij Statuti.

#### **NENI 8 ZMADHIMI/ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR**

- 8.1 Ortakët/ortaku nuk kufizohen në rritjen e kapitalit themeltar. Zvogëlimi i kapitalit themeltar bëhet nga Ortakët/ortaku deri në kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 8.2 Raporti i zmadhimit ose zvogëlimit të kapitalit miratohet në mënyrë të shprehur nga shumica e ortakëve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e pjesëve të kapitalit themeltar.

#### **KAPITULLI III ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË DHE KOMPETENCAT E TYRE**

##### **NENI 9 ORGANET DREJTUESE**

- 9.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:
- Asambleja e Përgjithshme
  - Administratori.

##### **NENI 10 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, KOMPETENCAT E SAJ**

- 10.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë drejtues i shoqërisë.
- 10.2 Asambleja e Përgjithshme drejton veprimtarinë e shoqërisë nëpërmjet marrjes së vendimeve. Vendimet që mund të marrë Asambleja e Përgjithshme përfshijnë kryesisht vendime për:
- Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
  - Ndryshimet në Statut;
  - Rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
  - Shitjen, transferimin dhe anulimin e kuotave të kapitalit themeltar;
  - Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - Emërimin dhe shkarkimin e Ekspertit kontabël dhe të likuidatorëve si dhe caktimin e shpërblimit të tyre.
  - Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, duke përfshirë edhe

- Miratimin e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- Lëshimin e çertifikatës së aftësisë paguese të shoqërisë;
- Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

#### NENI 11 THIRRJA DHE ZHVILLIMI I Mbledhjeve

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret në çdo kohë nga Administratori ose një apo disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të pjesëve të kapitalit themeltar. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së përgjithshme thirret të paktën 1 (një) herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.
- 11.2 Mbledhjet zhvillohen në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të njoftuar nga Administratori.
- 11.3 Njoftimi kryhet me shkrim ose me postë elektronike jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

#### NENI 12 MARRJA E VENDIMEVE

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme, në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kuotave.
- 12.2 Vendimet e Asamblesë, për të cilat kërkohet një shumicë e kualifikuar, sipas përcaktimit të nenit 12, pika 3, të këtij Statuti, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm në mbledhje ortakët që zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të numrit total të votave.
- 12.3 Asambleja e Përgjithshme vendos me  $\frac{3}{4}$  e votave të ortakëve pjesëmarrës për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjes së fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 12.4 Nëse Asambleja nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në nenin 12, pikat 1 dhe 2 të këtij Statuti, Asambleja do të mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
- 12.5 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme. Procesverbali nënshkruhet nga kryetari dhe mbajtësi i procesverbalit.

#### NENI 13 ADMINISTRATORI TË DREJTAT DHE Detyrimet e Tili



- 13.1 Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë.
- 13.2 Shoqëria do të administrohet nga **Z. Taulant Godroli lindur me dt. 08.02.1988**, ne Tirane, banues ne Tirane, mbajtës i leternjoftimit me Nr. Personal I80208066O, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar;
- 13.3 Administratori ka të drejtë e detyrohet:
- Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
  - Të përfaqësojë shoqërinë tregtare në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose duke caktuar zëvendësues;
  - Të kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë;
  - Të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë;
  - Të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - Të kryejë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sipas parashikimeve të ligjit “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
  - Të raportojë para Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë.
- 13.4 Administratori emërohet për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripërtëritjeje.

#### KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI DHE FITIMET

##### NENI 14 VITI FINANCIAR

- 14.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor.
- 14.2 Si përjashtim, viti i parë i veprimtarisë së shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2018.
- 14.3 Shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, afatet e derdhjes së tij, sigurimet shoqërore etj. Ajo ka të drejtë të çelë llogari likuiduese pranë bankave dhe të kryejë veprime likuiduese me to, brenda dhe jashtë vendit.
- 14.4 Llogaritë vjetore, inventarët, raportet mbi operacionet e vitit financiar miratohen nga Asambleja e Ortakëve të shoqërisë.
- 14.5 Miratimi i dokumenteve që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

**NENI 15**  
**BILANCI, MBAJTJA E KONTABILITETIT**

- 15.1 Bilanci vjetor i shoqërisë duhet të hartohet për t'iu paraqitur organeve tatimore deri në fund të muajit Mars të vitit pasardhës.
- 15.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe në monedhën shqiptare. Shoqëria mund të ketë edhe llogari të veçanta në valutë të cilat do të konvertohen çdo muaj në monedhën shqiptare.
- 15.3 Pas shlyerjes së detyrimeve fiskale ndaj shtetit, fitimi neto mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit, për rritjen e kapitalit të shoqërisë ose i shpërndahet ortakëve sipas kuotave të zotëruara.

**NENI 16**  
**FITIMET**

- 16.1 Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë, në raport me kuotat që ata zotërojnë.
- 16.2 Të ardhurat që do të rezultojnë deri në fund të mbylljes së çdo viti ushtrimor, mund të ndahen ndërmjet ortakëve në raport me pjesët që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë, vetëm nëse:
- Aktivët e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
  - Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

**KAPITULLI V**  
**PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

**NENI 17**  
**PRISHJA E SHOQËRISË**

- 17.1 Shoqëria prishet:
- në përfundim të afatit të parashikuar nga Statuti;
  - me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
  - me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - me vendim të gjykatës.
- 17.2 Administratori do të regjistrojë vendimin për prishjen e shoqërisë, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Tregtare të Regjistrimit". Në rast se prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare për Regjistrim.



## NENI 18 LIKUIDIMI I SHOQËRISË

- 18.1 Në rast prishjeje shoqëria duhet të likuidohet.
- 18.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Ortakëve emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raporte përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 18.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja vendos mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesit dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 18.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit Ortakëve të shoqërisë, në proporcion me kuotat e kapitalit të zotëruara prej tyre.
- 18.5 Likuidatori/ët njoftojnë Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e procesit të likuidimit duke kërkuar çregjistrimin e shoqërisë në përputhje me parashikimet e ligjit "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

## NENI 19 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 19.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 19.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje të mosmarrëveshjeve me mirëkuptim, ato do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

## KAPITULLI VI DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

### NENI 20

- 20.1 Ky statut është hartuar në përputhje me:
- i) Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar;
  - ii) Ligjin Nr. 9723, datë 03/05/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar.
  - iii) Ligjin Nr. 125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat" i ndryshuar.
- 20.2 Për çështje që nuk janë shprehur plotësisht në këtë Statut, shoqëria i referohet Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.

20.3 Ky Statut, përbëhet nga 20 nene dhe u redaktua në 3 (tre) kopje identike në gjuhën shqipe, duke patur të gjitha fuqi të njëjtë ligjore.

## ORTAKËT



**KONTRATË PËR HARTIMIN E AKTIT TË THEMELIMIT TË  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“ECO CLEANING” SH.P.K.**

Sot, më datë 30.05.2018 (dy mijë e tetëmbëdhjetë), pala e mëposhtme:

**Shoqëria “ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” shpk**, , me numwr biznesi **70086447**, me seli ne adresen: Rr. “Ndue Pwrlleshi”, Kompleksi USLUGA PRISHTINW Kosovw, perfaqesuar nga administrator i saj, Imer Ademi i lindur i mbajtës i letërnjoftimit nr të lëshuar nga i . Së Kosovës me he me afat skadimi

**Shoqëria 2T shpk**, person juridik regjistruar me NUIS K017310M me adresë në Tiranë perfaqesuar nga Administratori Artan Sako, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr.

kanë vendosur të nënshkruajnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**ECO CLEANING**” SHPK, aktiviteti i së cilës rregullohet nga ky Akt Themelimi, Statuti dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

**NENI 1  
ORTAKËT THEMELUES**

**1.1** Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar krijohet nga ortaku i mëposhtëm:

- **Shoqëria “ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” shpk**, , me numwr biznesi **70086447**, me seli ne adresen: Rr. “Ndue Pwrlleshi”, Kompleksi USLUGA PRISHTINW Kosovw, perfaqesuar nga administrator i saj. Prishtinë, mbajtës i letërnjoftimit me nr
- **Shoqëria 2T shpk**, person juridik regjistruar me NUIS K017310M me adresë në Tiranë perfaqesuar nga Administratori Artan Sako, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal

**NENI 2  
BAZA LIGJORE**

- 2.1** Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, si dhe të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar dhe ligjit 125/2013 “Për Koncesionet dhe Parneteritin Publik Privat”
- 2.2** Kjo shoqëri fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

**NENI 3  
EMËRTIMI**

- 3.1 Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “ECO CLEANING” SHPK.

**NENI 4  
SELIA**

- 4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Rreshit Petrela, Kompleksi USLUGA, pallati nr.53, njësia administrative nr. 9 Tiranë.

**NENI 5  
OBJEKTI**

- 5.1 Objekti i aktivitetit të kësaj shoqërie është:

Shërbim i pastrimit, grumbulimit, transportit dhe seleksionimit të mbetjeve urbane nëpërmjet ndërtimit të impianit të diferencimit për Qytetin e Kamzës dhe transferimi te Autoritetit Kontraktor.

**NENI 6  
KOHËZGJATJA**

- 6.1 Shoqëria ka një kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) vjetësh. Ajo mund të përfundojë veprimtarinë përpara këtij afati në rastet e prishjes, falimentimit ose të likuidimit të shoqërisë të parashikuara këto në legjislacionin tregtar shqiptar në fuqi.

**NENI 7  
KAPITALI THEMELTAR**

- 7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 10,000 (dhjetemijë) Lekë i ndarë në 2 (dy) kuota. Çdo kuotë njësi jep të drejtën e një vote. Kapitali themeltar i shoqërisë nënshkruhet tërësisht nga Ortakët.
- 7.2 Pjesët e kapitalit të shoqërisë zotërohen nga Ortakët, si më poshtë vijon:
- **Ortaku “ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” SHPK**, zotëron 1 (një) kuotë, të barabartë me 95% (nëntëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit themeltar.
  - **Ortaku “2T” SHPK**, zotëron 1 (një) kuotë, të barabartë me 5% (njëqindpërqind) të kapitalit themeltar.

**NENI 8**

- 8.1



**Z. Taulant Godroli**, shtetas shqiptar, lindur me 08.02.1988 ne Tirane, banues ne Tirane, mbajtës i leternjofimit me Nr. Personal 1802080660, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar;

- 8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit, në përputhje me parashikimet e Statutit të shoqërisë dhe të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 8.3 Administratori emërohet për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje.

#### **NENI 9 DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në përputhje me ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, si dhe me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar si dhe ligjin 125/2013 “Për Konceisonet dhe Parneteritetin Publik Privat” i ndryshuar.
- 9.2 Çështjet që nuk trajtohen në këtë Akt Themelimi, rregullohen në Statut, si dhe në legjislacionin përkatës shqiptar.
- 9.3 Ky Akt Themelimi është hartuar në Tiranë, Shqipëri, në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe, duke patur të gjitha fuqi të njëjtë ligjore.

#### **O R T A K Ë T**

**“ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION”**  
**IMER ADEMI**

**"2T "**  
**ARTAN SAKO**